

**MARRËVESHJE PËR
BASHKËPUNIM NË FUSHËN E
PATENTAVE
(MARRËVESHJE PËR
BASHKËPUNIM)**

Publikuar në “Gazetën zyrtare të RM-së” nr. 49/97 më 30 shtator 1997

QEVERIA e palës që lidh këtë marrëveshje (“Vendit”), përfaqësuar nga Abdimenaf Neziri, Ministër për zhvillim
ORGANIZATA EVROPIANE E PATENTËS (“Organizata”), përfaqësuar nga Ingo Kober, Kryetar i Entit Evropian për Patentë (EEP)

DUKE U THIRRUR në Konventën për ndarjen e patentave evropiane të 5 tetorit të vitit 1973 (Konventa Evropiane për patentë), dhe veçanërisht të nenit 33 (4) nga e njëjta, të Ligjit për pronësi industriale të Vendit, nga 15 korrikut i vitit 1993, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 42/93 (Ligji për pronësi industriale), veçanërisht të nenit 8 paragrafi 3

DUKE MARRË PARASYSHË atë se Ligji për pronësi industriale i Vendit siguron shkallë të mbrojtjes të ngjashëm me atë i cili ekziston në shtetet anëtare të Organizatës Evropiane të patentës, atë se Vendi do të sigurojë sistem me të cilin do të mundësohet që efektet e patentave evropiane të zgjerohen në territorin e tij në përputhje me dispozitat e bashkangjitura në këtë marrëveshje (“Sistemi i zgjerimit”),

DUKE MARRË PARASYSHË kërkesën e Vendit për përkrahje administrative nga ana e EEP-së gjatë zbatimit të sistemit të këtillë

TË BINDUR se bashkëpunimi midis Organizatës dhe Vendit është me interes për të dyja palët dhe se do ta forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale në Evropë,

BIEN DAKORD PËR SA VIJON

Neni 1

Lënda e marrëveshjes

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në kuadër të kësaj marrëveshjeje që edhe më tutje ta zhvillojnë infrastrukturën e sistemit efikas të patentës në Vend.

Neni 2

Bashkëpunimi teknik

Në kuadër të fushëveprimit të saj Organizata EEP do të i ndihmojë Vendit veçanërisht gjatë:

- a) sigurimit të trajnimit bazik dhe specializimit për të punësuarit në Entin e saj për mbrojtje të pronësisë industriale (“Entin”) dhe për specialistë nga trupa të tjerë qeveritarë puna e të cilëve përfshinë lëndë që kanë të bëjnë me patentën;
- b) organizimin dhe zhvillimin e sistemit të saj të agjentëve të patentës;
- c) zhvillimi i dokumentacionit adekuat për shërbime informuese të patentove;
- ç) lëshimi i publikimeve zyrtare të Entit;
- d) modernizimin e sistemit informativ patentor;
- dh) vendosja e sistemeve procesore për azhurimin e procedurës për njohjen dhe administrimin e patentave.

Neni 3

Bashkëpunimi juridik dhe administrativ

- (1) Palët nënshkruese rregullisht do të shkëmbejnë informata për zhvillimin juridik i cili ka të bëjë me sistemin adekuat patentor.
- (2) Nëse atë e kërkon Vendi, Organizata i jep këshilla për propozimet për miratimin e ligjit, ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me sistemin e saj patentor.
- (3) EEP dhe Enti do të bashkëpunojnë gjatë përgatitjes për vendosjen e sistemit të zgjerimit.

Neni 4

Përpunimi i kërkesës për zgjerim

(1) EPP do të pranojë, përpunojë dhe publikojë çdo kërkesë për zgjerim të patentave evropiane në Vend dhe Entit të tij do të ia dërgojë të gjitha informatat e nevojshme lidhur me procedurat të cilat kanë të bëjnë me fletëparaqitjet për Patentë Evropiane dhe patenta adekuate.

(2) Në kuadër të mundësive të veta, kërkesën e Entit, EPP do ta plotësojë me dërgimin e çdo informate të dobishme.

Neni 5

Informatë që ka të bëjë me patentat e zgjeruara evropiane

Enti do ta informojë EPP-në për statusin juridik të çdo patente të zgjeruar evropiane, e veçanërisht nëse ai është anuluar, i ka kaluar afati, është hequr dorë nga ai apo nëse ka pushuar së ekzistuari.

Neni 6

Financat

(1) Taksa për zgjerim do të jetë 200 DM për çdo kërkesë për zgjerim, kurse pagesa do të kryhet në llogarinë e EEP-së. 150 DM nga taksa për zgjerim do ti takojnë Entit dhe do të transferohen në llogarinë e tij, që të shfrytëzohen për promovimin e pronësisë industriale në Vend, përfshirë këtu edhe përkrahjen gjatë patentimit të shpikjeve të tyre jashtë vendit. EEP do të mbajë 50 DM nga taksa për zgjerim për shkak të mbulimit të harxhimeve të cilat i bën gjatë përmbushjes së detyrave nga sistemi për zgjerim.

(2) Shuma nga taksa për zgjerim si edhe pjesa të cilën e mban EEP-ja mund edhe të ndryshohen me marrëveshje midis Kryetarit të EEP-së dhe Drejtorit të Entit.

Neni 7

Komiteti i përbashkët

(1) Do të formohet komitet i përbashkët që të diskutojë rreth të gjitha çështjeve që do të dalin nga kjo marrëveshje dhe zbatimi i saj. Komiteti do të përbëhet nga përfaqësues të EEP-së dhe të Entit. Mund të konsultohen edhe përfaqësues nga trupa të tjerë qeveritarë të cilët janë të përfshirë apo drejtpërsëdrejti i tangon zbatimi i Marrëveshjes.

(2) Komiteti do të takohet me iniciativë të Drejtorit të Entit apo të Kryetarit të EEP-së. Rendi i ditës për çdo mbledhje si edhe vendi dhe data e mbajtjes së të njëjtës do të caktohen me pajtimin e të dyja palëve.

Neni 8

Zbatimi i marrëveshjes

(1) Detyrat që do të dalin nga palët kontraktuese si rezultat i kësaj marrëveshjeje do të zbatohen nga ana e EEP-së dhe Entit. EEP mund të ju besojë detyra të caktuara në pajtim me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, enteve të patentave të shteteve kontraktuese të Konventës Evropiane të patentave, me pajtimin e tyre.

(2) Hollësitë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të caktohen me pajtim midis Drejtorit të Entit dhe Kryetarit të EEP-së.

Neni 9

Ndryshimi i marrëveshjes

Me kërkesë të Organizatës apo të Vendit, palët kontraktuese do tu qasen bisedimeve rreth ndryshimit të Marrëveshjes.

Neni 10

Kohëzgjatja e marrëveshjes

(1) Kjo marrëveshje lidhet për periudhën prej pesë viteve dhe mund të vazhdohet me pajtim midis palëve kontraktuese për periudha të mëtutjeshme për ripërtëritjen e Marrëveshjes prej dy viteve. Pajtimi i këtillë duhet të arrihet më së voni gjashtë muaj para skadimit të afatit të Marrëveshjes.

(2) Nëse kjo marrëveshje prishet, nenet prej 4 deri në 6 do të vazhdojnë të zbatohen në çdo fletëparaqitje për patentë evropiane për të cilin para se kjo marrëveshje të prishet është dorëzuar kërkesë për zgjerim, si edhe për çdo patentë evropiane të fituar në bazë të të njëjtës.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Data në të cilën kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi do të caktohet me shkëmbimin e dyanshëm të notave midis të dyja palëve, në pajtim me dispozitat ligjore të Vendit të cilat janë në pajtueshmëri me atë në pjesën shtesë të kësaj marrëveshjeje.

Nënshkruar në Minhen më ____1997 në dy origjinale në gjuhën maqedonase, gjermane, angleze dhe franceze, gjatë së cilës secili tekst është autentik në mënyrë të barabartë.

Dispozita të cilat vlejné gjatë zgjerimit të patentave evropiane në Palën kontraktuese (“Vendin”)

Neni 1

Zgjerimi i efekteve të patentave evropiane

(1) Fletëparaqitja për patentë evropiane si edhe për patentë të zgjeruar evropiane në Vend e cila është lëndë e dispozitave të përmbajtura këtu, do të prodhojë pasoja dhe do të trajtohet në të njëjtat kushte si edhe fletëparaqitja kombëtare për patentë dhe patentë nacionale sipas Ligjit për pronësi industriale në Vend;

(2) Për nevojat e këtyre dispozitave:

(a) *“Fletëparaqitja për patentë evropiane”* do të thotë fletëparaqitja e patentave evropiane e dorëzuar sipas Konventës Evropiane për patentë, si edhe fletëparaqitje ndërkombëtare e dorëzuar sipas Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e patentave (RST) për të cilën Enti Evropian për patentë (EEP) vepron si Ent i përzgjedhur apo i caktuar edhe në Vendin ku është caktuar;

(b) *“Patentë e zgjeruar evropiane”* do të thotë patentë evropiane e lëshuar nga ana e EEP-së në bazë të fletëparaqitjes për patentë evropiane për të cilin është kërkuar zgjerim për Vendin;

(c) *“Fletëparaqitje për patentë nacionale”* do të thotë fletëparaqitje për patentë e dorëzuar sipas Ligjit për pronësi industriale në Entin për mbrojtje të pronësisë industriale në Vend.

(ç) *“Patentë nacionale”* do të thotë patentë e ndarë për fletëparaqitje për patentë nacional.

Neni 2

Kërkesa për zgjerim

(1) Efektet nga fletëparaqitja për patentë evropiane dhe patenta e ndarë evropiane në bazë të fletëparaqitjes së këtyre do të zgjerohen në Vend me kërkesë të kërkuarit. Kërkesa për zgjerim do të konsiderohet si e dorëzuar me cilëndo fletëparaqitje për Patentë Evropiane e dorëzuar në apo pas datës në të cilën Marrëveshja për bashkëpunim midis Qeverisë së Vendit dhe Organizatës Evropiane të patentave do të hyjë në fuqi.

(2) Çdo kërkesë për zgjerim do të publikohet nga ana e Entit në afatin më të shkurtër të mundshëm pas marrjes së njoftimit nga EEP-ja se është paguar taksa e caktuar, por jo më herët se pas skadimit të 18 muajve nga data e paraqitjes apo, nëse paraprakisht është kërkuar, data më e hershme e prioritetit.

(3) Kërkesa për zgjerim mund të tërhiqet në çdo kohë. Do të konsiderohet si e tërhequr atje ku taksa e caktuar për zgjerim sipas nenit 6 të Marrëveshjes për

bashkëpunim nuk është paguar në kohë apo përsëri atje ku fletëparaqitja për patentë evropiane në mënyrë definitive është refuzuar, tërhequr apo konsiderohet si e tërhequr. Enti do ta publikojë këtë në afatin më të shkurtër të mundshëm derisa kërkesa për zgjerim veç më është publikuar

Neni 3 **Taksa për zgjerim**

(1) Taksa për zgjerim sipas nenit 2 (2) do ti paguhet EEP-së në afatet e caktuara të dhëna sipas EPK-së për pagesë të taksave për emërim.

(2) Taksa për zgjerim mund të paguhet edhe pas skadimit të afatit nëse paguhet në grejs-periudhë, në pajtim me rregullën 85-a(2) të EPK-së e rritur për 50%.

(3) Për pagesën e taksës për zgjerim, Rregullat e EEP-së të cilat kanë të bëjnë me taksat, do të zbatohen mutatis mutandis. Taksa për zgjerim e cila parimisht është paguar, nuk do të kthehet.

Neni 4 **Efektet e fletëparaqitjeve për patentë evropiane**

(1) Fletëparaqitja për patentë evropiane e cila është në pajtim me datën e paraqitjes, duhet të jetë e barabartë me fletëparaqitjen nacionale, pa marrë parasysh se si do të jetë rezultati.

(2) Fletëparaqitja e publikuar e patentës evropiane përkohësisht do ta bartë mbrojtjen e dhënë në nenin 40 në Ligjin për pronësi industriale në Vend, duke filluar nga data në të cilën nga ana e kërkesit është dorëzuar përkthim i kërkesës për patentë nga fletëparaqitja e publikuar e patentës evropiane në gjuhën maqedonase deri te personi i cili e përdorë shpikjen në Vend.

(3) Fletëparaqitja për patentë Evropiane do të konsiderohet se nuk ka pasur ab inicio efekte në të cilat thirret dispozita 2 atje ku kërkesa për zgjerim është tërhequr apo është konsideruar si e tërhequr.

Neni 5 **Efektet e patentave evropiane**

(1) Patenta evropiane e zgjeruar, si lëndë e dispozitave nga 2 deri në 6, do ti bartë të drejtat e njëjta si edhe një patentë nacionale sipas neneve 35 dhe 36 të Ligjit për pronësi industriale të Vendit nga data e publikimit të patentës të pranuar nga ana e EEP-së.

(2) Në afat prej tre muajve nga data e publikimit të dhënies së Patentës Evropiane, pronari i patentës do të ia dorëzojë Entit përkthimin e kërkesës për patentë për Patentë Evropiane në gjuhën e Vendit dhe do ta paguajë taksën e caktuar për publikim.

(3) Nëse, si rezultat i ankesës së dorëzuar deri te EEP-ja, patenta evropiane mbahet me kërkesa të ndryshuara, pronari i patentës do të duhet që në afat prej tre muajsh nga data e çdo vendimi të publikuar për mbajtjen e patentës evropiane ashtu siç është ndryshuar, të dorëzojë deri te Enti përkthimin për kërkesat e ndryshuara në gjuhën e Vendit dhe ta paguajë taksën e caktuar për publikim.

(4) Enti do të publikojë çdo përkthim që është dorëzuar në mënyrë të rregullt sipas dispozitave 2 apo 3.

(5) Nëse përkthimi i specifikuar në dispozitat 2 apo 3 nuk është dorëzuar në

afatin e caktuar, apo nuk është paguar taksa e përcaktuar në afatin e caktuar, patenta e zgjeruar evropiane do të konsiderohet sikur nuk është dorëzuar ab initio.

(6) Patenta e zgjeruar evropiane, si edhe fletëparaqitja e patentës evropiane në të cilën ai bazohet, do të konsiderohen se kanë efekte ab initio të caktuar me nenin 1 dhe nenin 4 (2) deri në atë shkallë në të cilën patentimi është revokuar në procedurat e kundërshtimit para EEP-së.

Neni 6

Teksti autentik për fletëparaqitjet e patentave evropiane apo të patentave evropiane

(1) Teksti i fletëparaqitjes së patentës evropiane apo teksti i patentës evropiane në gjuhën në të cilën udhëhiqet procedura para EEP-së do të jetë tekst autentik dhe gjatë çdo procedure në shtetin kontraktues.

(2) Sido që të jetë, përkthimi, ashti siç është dhënë në nenet 4 dhe 5 do të konsiderohet si autentik, me përjashtim të procedurave për revokim, ku fletëparaqitja e përkthyer apo patenta japin mbrojtje e cila është më e ngushtë se ajo që është në gjuhën e procedurave.

(3) Kërkuuesi apo pronari i patentës mund të dorëzojë përkthim të korrigjuar të kërkesës për patentë nga fletëparaqitja e patentës evropiane apo nga patenta evropiane. Përkthimi i korrigjuar nuk do të ketë asnjë efekt juridik derisa nuk publikohet nga ana e Entit. Të gjithë ata që me mendim të mirë e përdorin apo ndërmarrin përgatitje serioze për përdorim të shpikjes, kurse përdorimi i së cilës nuk do të paraqesë shkelje në kuptim të fletëparaqitjes apo patentës në përkthimin origjinal, mundet, pasi që përkthimi i korrigjuar të bëhet i plotfuqishëm, të vazhdojnë përdorimin e tillë në kuadër të veprimit të tij apo për nevojat të cilat dalin nga e njëjta, pa pagesë.

Neni 7

Të drejtat nga data e mëparshme

(1) Fletëparaqitja për patentë evropiane për të cilën është paguar taksë për zgjerim, si edhe patenta e zgjeruar evropiane do ta kenë efektin e njëjtë e gjendjes së mëparshme të teknikës si edhe fletëparaqitja për patentë nacionale sipas nenit 47 dhe 70 të Ligjit për pronësi industriale të Vendit.

(2) Fletëparaqitja për patentë nacionale dhe patenta nacionale në kuptim të patentës së zgjeruar evropiane do të kenë efektin e njëjtë të gjendjes së mëparshme të teknikës siç kanë në kuptim të patentës nacionale sipas neneve 47 dhe 70 të Ligjit për pronësi industriale të vendit.

Neni 8

Mbrojtja e njëkohshme

Atje ku patentës së zgjeruar evropiane dhe patentës nacionale, me datë të njëjtë të paraqitjes apo me kërkesë për përparësi, e njëjta datë e përparësisë i është ndarë individit të njëjtë apo të trashëgimtarit të tij ligjor, patenta nacionale nuk do të ketë efekt deri në atë shkallë sa do të përfshinte shpikjen e njëjtë si edhe patenta e zgjeruar evropiane, duke filluar në atë datë në të cilën kufizimi kohor për dorëzimin e kundërshtimit të patentës evropiane ka kaluar pa u dorëzuar kundërshtimi apo data në të cilën procedura për kundërshtim ka rezultuar me vendim përfundimtar për mbajtjen

e patentës evropiane.

Neni 9

Taksat për ripërtëritjen e patentës së zgjeruar evropiane

Taksat për ripërtëritjen e patentës së zgjeruar evropiane duhet të i paguhen Entit për vitet të cilat vijojnë pas vitit në të cilin është publikuar ndarja e patentës evropiane.

Neni 10

Zbatueshmëria e BPK-së

Rregullat e EEP-së dhe dispozitat e saj përmbarese nuk do të zbatohen nëse në këto dispozita është përcaktuar ndryshe.